



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit



Shkresë	07.11.2023
Nga:	ZPP GEZIM HAJDINI
PER:	INVEST PRO SH.P.K.
Lenda :	VENDIM



Konform Ligjit mbi Prokurimin Publik nr 04/L-042, i ndryshuar dhe njoftuesur me ligjin Nr 05/L-068 dhe ligjin nr 05/L-92 Ligji mbi Prokurimin publik ne Kosovë, përkatesisht neni 108/A pika 2 dhe neni 6 pika 1 e Rregullave për parashtrimin e kërkesave për Rishqyrtim per Vendim te Autoritetit Kontraktues , Zyra e Prokurimit në Drenas nxjerrë :

VENDIM

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa e operatorit ekonomik "INVEST PRO SH.P.K." kunder vendimit të autoritetit kontraktues "FUSHAT SPROTIVE DHE REKREACION DRITAN, LLAPUSHNIK DHE TERSTENIK" me nr 611-23-10159-5-2-1 si e pabazuar

OE ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim te AK me datën 06.11.2023 kunder vendimit te AK dhe refuzohet si e pabazuar.

Argumentet e refuzimit te kërkeses per ri-shqyrtim jane si me poshte :

1. Kërkesa qe është kërkuar te Kapaciteti teknik dhe profesional pika 3 është përmbushur ne tersi nga ne si OE por për arsye te panjohura as qe e keni marr mundin te kërkonit sqarime shtese siç parashihet ne LPP përkatësisht nenin 59 dhe 72 , nenin 38 te rregullores por keni vepruar direkt me eliminim. Ne e plotësojmë këtë pike i tere dokumentacioni është i bashkëngjitur dosjes duke përfshire Parakonraten , diplomën , CV , certifikatën ashtu siç kërkohet ne njoftimin për kontrate Inxhinieri i ofruar ne dosje z. Fetah Salihu posedon diplomën e master te makinerisë te përfunduar ne Fakultetin Teknik ne Sofie dhe gjithashtu është i certifikuar për saldim IWS nga Instituti Welding Institue ashtu siç keni kërkuar ne dosje për me shume mund te shihni ne anën e djathte te certifikatës është llogoja e IWI dhe gjithashtu te gjitha dokumentet e kërkuara janë ne dosje

**2. Lidhur me pretendimet e juaj per piken e pare te kerkese se rishqyrtimit ,
pergjigja e AK eshte:**

Mungon një Inxhinier i makinerisë i certifikuar për saldim me certifikate International Welding Specialist (IWS) nga International Welding Institute (IWI)
Inxhinieri I propozuar ne dokumentet e paraqitura nga ana juaj nuk jane bindese per arsye se nuk ka nostrifikim te diplomes po ashtu as te noterizuara.

Kunder ketij vendimi keni te drejt ankese ne Oshp ne afate prej 10 dite .